

- не пријави исчезнување или оштетување на исправата издадена согласно со овој закон до Министерството за внатрешни работи во рок од два дена (член 59 став (1)) и

- дејствува спротивно на членот 62 од овој закон.

Член 95

За прекршоците утврдени со овој закон, прекршочната постапка ја води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.

ГЛАВА XI

ОВЛАСТУВАЊЕ ЗА ДОНЕСУВАЊЕ НА ПОДЗАКОНСКИ ПРОПИС

Член 96

Министерот за внатрешни работи донесува подзаконски пропис за образецот на потврда за искажаната намера за поднесување на барање за признавање право на азил, образецот на барањето за признавање право на азил, образецот за првичен разговор за регистрација на барател на азил, образецот на записник за спроведен разговор во врска со поднесено барање за признавање право на азил, образецот на записникот за прием на усно барање за признавање право на азил, образецот на барањето за признавање право на азил по основ на семејно обединување, начинот на земање на отпечатоци од прсти и фотографирање на барателите на право на азил, образецот и начинот на издавање и замена на исправи на баратели на право на азил и лица на кои им е признаено право на азил или привремена заштита (идентификациона исправа за барател на право на азил, лична карта на лице со статус на бегалец, лична карта на лице под супсидијарна заштита, патна исправа на лице со статус на бегалец, идентификациона исправа за лица под привремена заштита) во Република Македонија и за начинот на водење на евиденција.

ГЛАВА XII

ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 97

Подзаконските прописи предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 98

Постапките започнати до денот на влегувањето во сила на овој закон, ќе завршат согласно со одредбите од Законот за азил и привремена заштита („Службен весник на Република Македонија“ број 49/2003, 66/2007, 142/2008, 146/2009, 166/12, 101/15, 152/15, 55/16 и 71/16).

Член 99

Исправите издадени согласно со прописите кои важеле до денот на влегувањето во сила на овој закон, ќе продолжат да важат до истекот на рокот на важење наведен во истите.

Член 100

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за азил и привремена заштита („Службен весник на Република Македонија“ број 49/2003, 66/2007, 142/2008, 146/2009, 166/12, 101/15, 152/15, 55/16 и 71/16).

Член 101

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE DHE TË PËRKOHSHME(*)

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Lënda e ligjit

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe procedura për marrjen e të drejtës së mbrojtjes ndërkombëtare (në tekstin e mëtutjeshëm: e drejtë e azilit), si dhe pushimi, heqja dhe anulimi i të drejtës së azilit të të huajt apo personit pa shtetësi (në tekstin e mëtutjeshëm: i huaj), si dhe të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve të të drejtës së azilit dhe personave të cilëve u është pranuar e drejta e azilit në Republikën e Maqedonisë.

(2) Me këtë ligj rregullohen edhe kushtet sipas të cilave Republika e Maqedonisë mund të japë mbrojtje të përkohshme, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave nën mbrojtje të përkohshme.

(*) Me këtë ligj bëhet harmonizimi me direktivat evropiane në sferën e azilit, përkatësisht mbrojtjes ndërkombëtare edhe atë: 1.DIREKTIVA 2011/95/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT prej 13 dhjetor 2011 për standardet që duhet t'i plotësojnë personat që janë shtetas të vendeve të treta ose janë persona pa shtetësi që të kualifikohen si shfrytëzues të mbrojtjes ndërkombëtare, për status të barabartë për refugjatë ose për persona me të drejtë të mbrojtjes subsidiare dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë CELEX numër 32011L0095;

2.DIREKTIVA 2013/32/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT prej 26 qershor 2013 për procedurë të përbashkët gjatë ndarjes dhe tërheqjes së mbrojtjes ndërkombëtare CELEX numër 32013L0032 ; 3.DIREKTIVA /2013/33/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT prej 26 qershor 2013 për përcaktimin e standardeve për pranimin e kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare CELEX numër 32013L0033 dhe 4.DIREKTIVA E KËSHILLIT 2001/55 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT prej 20 korrik 2001 për minimum standarde për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rast të ardhjes masive të personave të shpërngulur të cilët nuk kanë mundësi të kthehen në vendin e tyre dhe vendosjen e baraspeshës ndërmjet aktiviteteteve të vendeve anëtare gjatë pranimit të personave të shpërngulur, si edhe gjatë bartjen e pasojave nga aktivitetet e tilla CELEX numër 32001L0055.

Kuptimi i shprehjeve të veçanta

Neni 2

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë domethënie si vijon:

1. **"Mbrojtje ndërkombëtare"** është status i refugjatit apo status i personit nën mbrojtje subsidiare.

2. **"Konventa e Gjenevës"** është Konventë për statusin e refugjatëve nga viti 1951 dhe Protokollin për statusin e refugjatëve nga viti 1967.

3. **"Mbrojtje e përkohshme"** është mbrojtje e ndarë në procedurë të veçantë në rast të ardhjes masive apo rrezikut të drejtëpërdrejtë nga ardhja masive e personave të shpërngulur nga vendet e treta, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të prejardhjes, posaçërisht nëse ekziston rreziku procedura për njohjen e të drejtës së azilit të mos mund të zbatohet për shkak të ardhjes masive, ndërsa në interes të personave të shpërngulur dhe personave tjerë të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

4. **"Ardhje masive"** apo "rrezik i drejtëpërdrejtë nga ardhja masive" është arritje e drejtëpërdrejtë e një numri të madh të personave të shpërngulur të cilët vijnë nga vendet konkrete apo rajonet gjeografike pa marrë parasysh nëse ardhja e tyre është spontane apo e ndihmuar.

5. **"I huaj"** është person i cili nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë, si dhe person pa shtetësi, përkatësisht person i cili asnjë shtet me fuqi të ligjit të vet nuk e konsideron si shtetas të vet.

6. **"Status i refugjatit"** është pranimi i të huajit se është refugjat.

7. **"Person nën mbrojtje subsidiare"** është i huaj i cili i plotëson kushtet për njohjen e statusit të personit nën mbrojtje subsidiare në kuptim të nenit 9 të këtij ligji.

8. **"Statusi i personit nën mbrojtje subsidiare"** është njohja e të huajit si person nën mbrojtje subsidiare.

9. **"Anëtarë të familjes"** janë bashkëshorti, nëse martesë është lidhur para ardhjes në Republikën e Maqedonisë, bashkëshort jashtëmartesor, fëmijë të moshës së mitur të cilët nuk janë të martuar, prindër të personave të moshës së mitur nëse fëmijët e moshës së mitur kanë marrë të drejtën e azilit apo person tjetër i moshës madhore në pajtim me ligj.

10. **"Person i moshës së mitur"** është i huaji i cili nuk i ka mbushur 18 vjet.

11. **"Person i moshës së mitur pa shoqërim"** është i huaji i cili nuk i ka mbushur 18 vjet, ndërsa arrin në territorin e Republikës së Maqedonisë pa shoqërimin e prindit apo kujdestarit, ka mbetur pa shoqërimin e tillë pasi që ka hyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë, apo për të cilin nuk ekziston kujdes efektiv.

12. **"Vendi i prejardhjes"** është vendi shtetësinë e të cilit e ka i huaji apo për persona pa shtetësi, vend i qëndrimit paraprak të zakonshëm.

E drejta e azilit

Neni 3

E drejta e azilit u jepet në kushte dhe procedurë të parapara me këtë ligj, kategorive të personave si vijojnë:

- personi me status të refugjatit (refugjat në pajtim me Konventën e Gjenevës) dhe

- personi nën mbrojtje subsidiare në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Kërkuesi i të drejtës së azilit

Neni 4

(1) Kërkuesi i së drejtës së azilit është person i huaj i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare nga Republika e Maqedonisë, i cili ka treguar qëllim apo ka parashtruar kërkesë për pranimin e të drejtës së azilit, për të cilën nuk është miratuar vendimi përfundimtar në procedurën për njohjen e të drejtës së azilit.

(2) Kërkesë për njohjen e të drejtës së azilit nga paragrafi (1) i këtij neni është kërkesë e parashtruar nga personi i huaj, e cila mund të kuptohet si kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Personi me status të refugjatit

Neni 5

Personi me status të refugjatit është person i huaj për të cilin pas shqyrtimit të kërkesës së tij i pranohet statusi i refugjatit dhe për të cilën është përcaktuar se i plotëson kushtet e caktuara me Konventën e Gjenevës, përkatësisht personi i cili për shkak të frikës së arsyetuar se do të jetë i përndjekur për shkak të racës së vet, fesë, kombësisë, përkatësisë së grupit të caktuar social apo për shkak të bindjes së tij politike, është jashtë shtetit shtetas i të cilit është dhe nuk mund, apo për shkak të frikës së tillë, nuk dëshiron të jetë nën mbrojtje të atij shteti apo i cili nëse është pa shtetësi është jashtë shtetit në të cilin ka pasur vend të zakonshëm të qëndrimit, nuk mund apo për shkak të frikës së tillë nuk dëshiron të kthehet në të.

Vepra të përndjekjes

Neni 6

(1) Veprat e përndjekjes sipas nenit 1 A nga Konventa e Gjenevës doemos duhet të:

- jenë mjaftë të rënda sipas natyrës së tyre apo përsëritjes që të paraqesin shkelje serioze të të drejtave themelore të njeriut, ndërsa posaçërisht ato të drejta të cilat nuk mund të jenë të kufizuara në pajtim me nenin 15 paragrafin (2) nga Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore ose

- paraqesin përmbledhje të masave të ndryshme të cilat përfshijnë edhe shkelje të të drejtave të njeriut që është mjaftë serioze që të ndikon mbi një individ në mënyrë të ngjashme, siç është theksuar në paragrafin (1) alineja 1 të këtij neni.

(2) Veprat e përndjekjes nga paragrafi (1) i këtij neni mund, mes tjerash, të kenë formë të:

-veprave të dhunës fizike apo mentale, duke përfshirë edhe vepra të dhunës seksuale,

-masave ligjore, administrative, policore dhe/apo gjyqësore që vetvetiu janë diskriminuese, apo që zbatohen në mënyrë diskriminuese,

-ndjekjes penale apo ndëshkimit i cili është joproporcional apo diskriminues,

-privimit nga mbrojtja gjyqësore që rezulton në dënim joproporcional apo diskriminues,

-ndjekjes penale apo dënimit për shkak të refuzimit të kryerjes së shërbimit ushtarak gjatë kohës së konfliktit, në raste kur përmeshja e shërbimit ushtarak do të thotë pjesëmarrje në vepra kriminale, apo vepra që hyjnë nën shkaqet për përjashtim, të përcaktuara në nenin 8 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

-veprave të cilat sipas natyrës së tyre janë të lidhura për gjini apo fëmijë.

(3) Lidhja ndërmjet veprave të përndjekjes nga paragrafi (1) i këtij neni dhe shkaqeve për ndjekje nga neni 7 i këtij ligji patjetër duhet të ekzistojë, në rast të mungesës së mbrojtjes nga veprat e përndjekjes.

Shkaqe për ndjekje

Neni 7

(1) Gjatë vlerësimit të shkaqeve se një person për shkak të frikës së arsyeshme do të ndiqet për shkak të racës së tij, fesë, kombësisë, përkatësisë në grup të caktuar social apo për shkak të bindjes së vet politike posaçërisht merren parasysh elementet nga paragrafët (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni për racën, fenë, kombësinë, përkatësinë në grup të caktuar social apo për shkak të bindjes së vet politike.

(2) Nocioni "racë" posaçërisht e përfshin ngjyrën e lëkurës, prejardhjen apo përkatësinë në grup të caktuar etnik.

(3) Nocioni "fe" përfshin besime teiste, joteiste dhe ateiste, pjesëmarrje apo përmbajtje nga pjesëmarrja në ceremoni fetare private apo publike, në mënyrë individuale apo në grup, ceremoni tjera fetare apo tregimi i pikëpamjeve apo formave të sjelljes personale apo të përbashkët që bazohet në sjellje fetare.

(4) Nocioni "kombësi" nuk kufizohet në shtetësi apo mospasjen e shtetësisë, por përfshin përkatësinë në grup të caktuar i cili është definuar sipas identitetit të vet kulturor, etnik dhe gjuhësor, prejardhje të përbashkët gjeografike apo politike apo lidhshmëri me popullsinë e shtetit tjetër.

(5) Nocioni "grup" ka të bëjë me përkatësinë në një grup të caktuar social që përfshin anëtarë të cilët kanë karakteristika të përbashkëta natyrore ose prejardhje të përbashkët, i cili nuk mund të ndryshohet, ose kanë karakteristika ose bindje që kanë rëndësi për identitetin ose vetëdijen e tyre, me ç'rast nuk mund ta detyrohet personi të heqë dorë prej tyre. Grupi ka identitet të ndarë qartë në shtetin e prejardhjes, pasi që konsiderohet si i ndryshëm nga shoqëria që e rrethon. Në varësi nga rrethanat e shtetit të prejardhjes, një grup social mund të shënojë edhe grup i cili bazohet në orientimin seksual. Orientimi seksual nuk konsiderohet për vepër e ndëshkueshme në pajtim me legjislacionin nacional. Elementet e lidhura me gjininë, të cilat e përfshijnë identitetin gjinor, duhet të merren parasysh gjatë caktimit të anëtarësisë apo karakteristikës së grupit të caktuar social.

(6) Nocioni "bindje politike" posaçërisht e përfshin mendimin personal, idetë dhe bindjet në lidhje me çështje të lidhura me kryerësit potencialë të ndjekjes dhe politikave apo metodat e tyre, pa marrë parasysh nëse kërkuesi i të drejtës së azilit ka ndërmarrë aktivitete në lidhje me bindjet e tyre.

(7) Gjatë vlerësimit nëse kërkuesi ka frikë të justifikuar nga ndjekja nuk ka rëndësi nëse kërkuesi me të vërtetë i posedon karakteristikat racore, religjioze, nacionale, sociale ose politike që e shkaktojnë ndjekjen e tillë, me kusht që kjo karakteristikë t'i përcaktohet nga ana e kryerësit të ndjekjes.

Shkaqe për përjashtimin e statusit të refugjatit

Neni 8

(1) Personi i huaj nuk mund ta gëzojë statusin e refugjatit, nëse:

- ai është nën mbrojtjen apo ndihmën e organeve apo agjencive të Kombeve të Bashkuara, përveç të Komisarariatit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara,

- nga ana e organeve kompetente të Republikës së Maqedonisë i janë pranuar të drejtat e barabarta dhe obligimet si shtetasve të Republikës së Maqedonisë,

- mbrojtja e përcaktuar në paragrafin (1) alineja 1 të këtij neni pushon nga cila do arsye, ndërsa statusi i tij nuk është përcaktuar në pajtim me rezolutat relevante të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, personi i huaj e fiton të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare në pajtim me dispozitat të këtij ligji.

(2) I huaji nuk mund ta gëzojë statusin e refugjatit nëse ekziston dyshimi i bazuar se:

- ka bërë vepër penale kundër paqes, krim kundër njerëzimit apo krim lufte, në pajtim me aktet ndërkombëtare me të cilat janë paraparë këto vepra penale,

- ka bërë vepër të rëndë penale (jopolitike) jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë para se të pranohet në të si refugjat apo

- është fajtor për veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

(3) Dispozita nga paragrafi (2) i këtij neni ka të bëjë me ato persona të cilët nxisin apo marrin pjesë në kryerjen e veprave penale apo veprimeve të cilat janë përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni.

Person nën mbrojtje subsidiare

Neni 9

(1) Personi nën mbrojtje subsidiare është i huaji, i cili nuk kualifikohet si person me status të refugjatit, ndërsa të cilit Republika e Maqedonisë do t'ia pranojë të drejtën e azilit dhe do të lejojë të mbetet në suazat e territorit të saj, pasi ekzistojnë shkaqe të besohet, se nëse kthehet në shtetin shtetas i të cilit është, apo nëse është person pa shtetësi, në shtetin e vet të qëndrimit të zakonshëm paraprak, do të ballafaqohet me rrezik real nga pësimi i lëndimeve serioze.

(2) Lëndime serioze, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, janë:

- dënimi me vdekje apo ekzekutimi,

- tortura apo veprimi jonjerëzor apo i degraduar ose dënimi apo

- kërcënime serioze dhe individuale për jetën apo personalitetin e personit civil, nëpërmjet dhunës jo diskriminuese, në situatë të konfliktit ndërkombëtar apo konfliktit të brendshëm të armatosur.

Shkaqe për përjashtim të mbrojtjes subsidiare

Neni 10

(1) I huaji nuk do ta gëzojë statusin e mbrojtjes subsidiare, nëse ekziston dyshim i bazuar se:

- ka bërë vepër penale kundër paqes, njerëzimit apo krim luftime, në pajtim me aktet ndërkombëtare me të cilat janë paraparë këto vepra penale,

- ka kryer vepër të rëndë penale,

- është i akuzuar për veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose

- paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Maqedonisë.

(2) I huaji nuk do ta gëzojë statusin e mbrojtjes subsidiare nëse nxit apo në mënyrë tjetër merr pjesë në kryerjen e veprave penale ose veprimeve të cilat janë përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Republika e Maqedonisë mund ta përjashtojë të drejtën e mbrojtjes subsidiare të personit të huaj nëse ai para pranimit në Republikën e Maqedonisë ka kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, ndërsa për të cilat është paraparë dënim me burg nëse do të ishin kryer në Republikën e Maqedonisë dhe nëse e ka lëshuar vendin e tij të prejardhjes me qëllimin e vetëm t'i shmang sanksionet për veprat e kryera penale.

Mbrojtja ndërkombëtare sur place

Neni 11

Të huajit i cili tanimë gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, mund t'i pranohet mbrojtja ndërkombëtare sur place në pajtim me nenet 5 dhe 9 të këtij ligji dhe në rastet kur frika e arsyetuar nga përndjekja apo rreziku i lartë nga pësimi i lëndimeve serioze është bazuar mbi ngjarje të cilat kanë ndodhur apo aktivitete në të cilat ka qenë i inkuadruar pasi e ka lëshuar vendin e prejardhjes, posaçërisht kur do të përcaktohet se aktivitetet paraqesin shprehjen dhe vazhdimin e bindjeve apo orientimeve të cilat i ka pasur në vendin e prejardhjes.

Kryerësit e ndjekjes apo dëmit serioz

Neni 12

Kryerësit e ndjekjes apo dëmit serioz janë:

- shteti,

- subjekte apo organizata të cilat e kontrollojnë shtetin ose pjesën më të madhe të territorit të saj dhe

- kryerësit të cilët nuk janë të lidhur me shtetin, nëse mund të dëshmohet se kryerësit nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, duke i inkuadruar edhe organizatat ndërkombëtare, nuk kanë mundësi apo nuk kanë vullnet të sigurojnë mbrojtje nga përndjekja apo nga lëndimet e rënda, siç është përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.

Dhënësit e mbrojtjes

Neni 13

(1) Mbrojtjen nga ndjekja apo dëmi serioz mund ta sigurojë vetëm:

- shteti ose

- subjekte ose organizata, duke i inkuadruar edhe organizatat ndërkombëtare të cilat e kontrollojnë shtetin apo pjesën më të madhe të territorit të shtetit nëse mund/kanë vullnet të ofrojnë mbrojtjen në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni.

(2) Dhënia e mbrojtjes nga paragrafi (1) i këtij neni nënkupton ndërmarrjen e veprimeve të arsyeshme që kanë për qëllim parandalimin e ndjekjes apo pësimin e dëmit serioz, mes tjerash, zbatimin e sistemit juridik efikas për zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e veprave të cilat e përbëjnë ndjekjen apo dëmin serioz dhe qasjen e kërkuarit të së drejtës së azilit deri te mbrojtja e atillë.

Parimi i moskthimit

Neni 14

(1) Kërkuesi i të drejtës së azilit, personi me statusin e refugjatit apo personi nën mbrojtje subsidiare nuk mund të dëbohet apo në cilën do mënyrë të kthehet në kufijtë e shtetit:

- në të cilin jeta e tij apo liria do të ishin në rrezik për shkak të racës së tij, fesë, kombësisë, përkatësisë në grup të caktuar social apo bindjes politike ose

- ku do të ishte i nënshtruar torturës, veprimt jonjerëzor apo nënçmues ose dënim.

(2) Ndalesa nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni nuk ka të bëjë me të huajin i cili paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Maqedonisë apo i cili, pasi kundër tij është miratuar vendim i plotfuqishëm për krim apo për shkak të veprës së rëndë penale, paraqet rrezik për qytetarët në Republikën e Maqedonisë.

(3) Të huajit nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni, i cili për shkak të arsyeve nga nenet 8 dhe 10 të këtij ligji nuk mund ta gëzojë të drejtën e azilit në Republikën e Maqedonisë, do t'i lejohet të mbetet në territorin e Republikës së Maqedonisë derisa në shtetin shtetas i të cilit është apo nëse është pa shtetësi në të cilin ka pasur vend të zakonshëm të qëndrimit, do të ishte i nënshtruar në përndjekje, torturë, veprim jonjerëzor apo nënçmues ose dënim.

Uniteti familjar

Neni 15

(1) Në procedurën për njohjen e të drejtës së azilit kërkuarit i garantohet mbajtja e unitetit familjar.

(2) Parimi i unitetit familjar nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të zbatohet për anëtarët e familjes të cilët në mënyrë individuale nuk e plotësojnë kushtin për marrjen e statusit të refugjatit, përkatësisht personit nën mbrojtje subsidiare në pajtim me ligj, nëse ekzistojnë shkaqet për përjashtim nga nenet 8 dhe 10 të këtij ligji.

Bashkimi familjar

Neni 16

(1) Për anëtarët e familjes më të ngushtë të personit me status të refugjatit dhe personit nën mbrojtje subsidiare, me kërkesë të tyre, do të zbatohet procedurë për njohjen e të drejtës së azilit.

(2) Për anëtarët e familjes më të ngushtë, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, konsiderohen bashkëshorti, nëse martesë është lidhur para ardhjes në Republikën e Maqedonisë, bashkëshorti jashtëmartesor, fëmijë të moshës së mitur të cilët nuk janë të martuar, prindërit e fëmijëve të moshës së mitur nëse fëmijët e moshës së mitur kanë marrë të drejtën e azilit dhe persona tjerë në pajtim me ligj.

(3) Parimi i bashkimit familjar nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të zbatohet nëse ekzistojnë shkaqet për përjashtim nga nenet 8 dhe 10 të këtij ligji.

(4) Të drejtën e bashkimit familjar me anëtarët e familjes më të ngushtë, personi me statusin e refugjatit e fiton pas marrjes së statusit të refugjatit, ndërsa personi nën mbrojtje subsidiare e fiton pas dy viteve nga marrja e statusit të personit nën mbrojtje subsidiare.

Vend i sigurt i prejardhjes

Neni 17

(1) Vend i sigurt i prejardhjes është shteti në të cilin shtetasit e tij apo personat pa shtetësi të cilët atje kanë vend të fundit të zakonshëm të qëndrimit janë të sigurt nga ndjekja për shkak të arsyeve nga neni 5 i këtij ligji apo nga pësimi i lëndimeve serioze të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, që përcaktohet posaçërisht në bazë të respektimit të të drejtave të njeriut të përcaktuara me aktet ndërkombëtare ekzistimi i institucioneve demokratike (procese demokratike, zgjedhje, pluralizëm politik, liria e mendimit dhe shprehja publike e mendimit, arritja dhe efikasiteti i mbrojtjes juridike) dhe stabiliteti i vendit.

(2) Gjatë bërjes së vlerësimit për vend të sigurt të prejardhjes nga paragrafi (1) i këtij neni për kërkuesin e të drejtës së azilit, mes tjerash, do të merret parasysh në cilin vëllim është paraparë mbrojtja nga ndjekja apo keqtrajtimi me:

- ligjet dhe rregullat në fuqi të vendit dhe mënyra në të cilën ato zbatohen,

- respektimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe/ose Pakti ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike dhe/ose Konventa kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit të ashpër, jonjerëzor apo nënçmues ose dënimit, posaçërisht të drejtat të cilat nuk mund të derogohen në bazë të nenit 15 paragrafi (2) nga Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,

- respektimi i parimit për moskthim në pajtim me Konventën e Gjenevës dhe

- ekzistimi i dispozitave për sistem efikas të mjeteve juridike kundër shkeljes së këtyre të drejtave dhe lirive.

(3) Kërkuesit të të drejtës së azilit gjatë procedurës për njohjen e të drejtës së azilit do t'i lejohet të kontestojë se vendi i prejardhjes është i sigurt për atë.

(4) Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme e përpilon listën e vendeve të sigurta të prejardhjes, e cila botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Vendi i parë i azilit

Neni 18

(1) Vendi i parë i azilit është shteti i cili përsëri do ta pranonte kërkuesin e të drejtës së azilit për shkak se:

- statusi i refugjatit i është pranuar në atë shtet dhe ende mund ta shfrytëzojë atë mbrojtje ose

- gëzon mbrojtje të mjaftueshme në atë shtet, duke i përfshirë përfitimet nga parimi i moskthimit.

(2) Kërkuesit të të drejtës së azilit gjatë procedurës për njohjen e të drejtës së azilit do t'i lejohet të kontestojë se vendi i parë i azilit është i sigurt për atë.

Vendi i tretë i sigurt

Neni 19

(1) Vendi i tretë i sigurt është shteti në të cilin kërkuesi i të drejtës së azilit është ndalur, para ardhjes në Republikën e Maqedonisë dhe në të cilin mund të supozohet se ai mund të kthehet i sigurt nga ndjekja, në kuptim të nenit 5 të këtij ligji, apo nga pësimi i lëndimeve serioze të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, ose nga tortura, veprimi ose dënimi jonjerëzor apo nënçmues.

(2) Si vendi i tretë i sigurt, do të konsiderohet shteti:

- në të cilin kërkuesit të të drejtës së azilit nuk do t'i rrezikohet jeta dhe liria në varësi nga rasa, feja, kombësia, përkatësia në grup të caktuar social ose bindjea politike,

- në të cilin nuk do të ballafaqohet me rrezik të vërtetë nga pësimi i shkeljeve serioze, në kuptim të nenit 9 paragrafi (2) të këtij ligji,

- i cili e respekton parimin për moskthim në pajtim me Konventën e Gjenevës,

- i cili e respekton ndalesën për mënjanim, gjatë shkeljes së të drejtës së azilit nga tortura dhe trajtimi i ashpër, jonjerëzor ose i degraduar, siç është përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare dhe

- në të cilin ekziston mundësia kërkuesi i të drejtës së azilit të parashtrijë kërkesë për njohjen e statusit të refugjatit dhe nëse përcaktohet se është refugjat, t'i sigurohet mbrojtje në pajtim me Konventën e Gjenevës.

(3) Kërkuesit të të drejtës së azilit gjatë procedurës për njohjen e të drejtës së azilit do t'i lejohet të kontestojë se vendi i tretë është i sigurt për atë.

(4) Parimi i vendit të tretë të sigurt nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të zbatohet nëse bashkëshorti/ja i/e kërkuesit të të drejtës së azilit, fëmijët ose prindërit në mënyrë ligjore qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë.

(5) Njësia organizative në Ministrinë e Punëve të Brendshme kompetente për azil (në tekstin e mëtutjeshëm: Sektori për azil) kërkuesit kërkesa e të cilit konsiderohet se është e palejuar në pajtim me nenin 46 të këtij ligji, do t'i jep vërtetim në gjuhën e vendit të tretë të sigurt prej nga vjen, me qëllim që të informohen organet shtetërore të vendit të tretë se në Republikën e Maqedonisë kërkesa nuk është shqyrtuar në mënyrë thelbësore, përkatësisht nuk janë vlerësuar shkaqet për ndarjen e statusit të refugjatit apo personit nën mbrojtje subsidiare në pajtim me ligj.

(6) Kur vendi i tretë i sigurt nuk do ta pranohet përsëri kërkuesin e të drejtës së azilit, Republika e Maqedonisë duhet t'i mundësojë qasje në procedurën për njohjen e të drejtës së azilit.

Organet për pranimin e të drejtës për azil

Neni 20

(1) Procedurën për pranimin e të drejtës për azil në shkallë të parë e udhëheq dhe vendimin e miraton Ministria e Punëve të Brendshme përmes Sektorit për azil.

(2) Kundër vendimit nga paragrafi (1) të këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Roli i Komisarariatit të Lartë për Refugjatë në Kombet e Bashkuara në procedurën për azil

Neni 21

(1) Organet nga neni 20 të këtij neni do të bashkëpunojnë me Komisariatin e Lartë për Refugjatë në Kombet e Bashkuara (në tekstin në vijim: Komisarati i Lartë për Refugjatë) në të gjitha fazat e procedurës për pranimin e të drejtës për azil.

(2) Komisariatit të Lartë për Refugjatë, organet kompetente në pajtim me ligjin i lejojnë qasje në informata për kërkesat individuale për njohjen e së drejtës për azil për rrjedhën e procedurës dhe për vendimet që miratohen, me pëlqimin e dhënë paraprakisht të kërkuesit të së drejtës së azilit.

(3) Ministria e Punëve të Brendshme përgatit dhe i dorëzon te Komisarati të Lartë për Refugjatë njoftimet dhe të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me pozitën e kërkuesve të së drejtës së azilit dhe personave të cilëve u është pranuar e drejta për azil në Republikën e Maqedonisë dhe për zbatimin e Konventës së Gjenevës, dispozitat e këtij ligji dhe rregullat tjera nga sfera e azilit.(4) Përfaqësuesit e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë i shprehin qëndrimet e tyre, në përputhje me nenin 35 të Konventës së Gjenevës para organeve kompetente, në përputhje me ligjin, në lidhje me kërkesat individuale për njohjen e së drejtës për azil, në cilëndo fazë të procedurës për pranimin e të drejtës për azil.

Ndihma juridike

Neni 22

(1) Kërkuesit e të drejtës së azilit kanë të drejtën e ndihmës juridike dhe shpjegimin në lidhje me kushtet dhe procedurën për njohjen e së drejtës për azil, si dhe të drejtën për ndihmë juridike falas në të gjitha fazat e procedurës, në përputhje me rregullat e ndihmës juridike falas.

(2) Kërkuesit e të drejtës për azil, në të gjitha fazat e procedurës mund të kontaktojnë persona të cilët ofrojnë ndihmë juridike dhe përfaqësuesit e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë.

(3) Përfaqësuesit e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë kanë të drejtë të hyjnë dhe të kontaktojnë me kërkuesit e të drejtës për azil, në të gjitha fazat e procedurës, kudo që të ndodhen ata.

**KAPITULLI II
PROCEDURA PËR PRANIMIN E TË DREJTËS PËR
AZIL****1. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA****Zbatimi i Ligjit për procedurë të përgjithshme dhe administrative**

Neni 23

Në procedurën për njohjen e së drejtës për azil zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Raporti me procedurën për lejimin e qëndrimit nga Ligji për të huajt

Neni 24

(1) Nga dita e shprehjes së qëllimit dhe parashtrimit të kërkesës për njohjen e së drejtës për azil deri në ditën e vendimit përfundimtar nuk do të zbatohen dispozitat e Ligjit për të huajt.(2) Kërkesa e paraqitur për njohjen e së drejtës për azil konsiderohet si tërheqje e kërkesës për lëshimin e lejes për qëndrim të të huajit në kuptim të dispozitave të Ligjit për të huajt.

Qëllimi për parashtrimin e kërkesës për pranimin e të drejtës për azil

Neni 25

(1) I huaji në pikën kufitare ose në brendësi të territorit të Republikës së Maqedonisë mund të shprehë gojarisht ose me shkrim qëllimin për paraqitjen e kërkesës për njohjen e së drejtës për azil (në tekstin e mëtejshëm:ka shprehur qëllim) para nëpunësit policor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(2) Nëpunësi policor nga paragrafi (1) i këtij neni regjistron të dhënat personale dhe të tjera të të huajit që ka shprehur qëllimin, e fotografon, ia merr shenjat e gishtërinjve, ia lëshon atij një kopje të vërtetimit për qëllimin e shprehur dhe e udhëzon që në afat prej 72 orësh të parashtrorë kërkesë për njohjen e së drejtës për azil para personit të autorizuar zyrtar në hapësirat e Sektorit për azil.

(3) I huaji që ka shprehur qëllimin e tij është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'i mundësojë nëpunësit të policisë t'i marrë të dhënat nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Në rast kur të huajit që ka shprehur qëllimin e tij nuk mund t'i merren shenjat e gishtërinjve për shkak mjekësore dhe arsye të tjera, të cilat nuk i ka shkaktuar qëllimisht, detyrohet t'i mundësojë nëpunësit policor marrje të shenjave të gishtërinjve në momentin e ndërprerjes së atyre shkaqeve.

(5) Të dhënat për të huajin që ka shprehur qëllim nëpunësit policorë i dorëzojnë në Sektorin për azil.

(6) Nëse i huaji nuk vepron në përputhje me dispozitat e paragrafëve (2), (3) dhe (4) të këtij neni vepron në përputhje me rregullat për të huajt.

Parashtrimi i kërkesës për pranim të së drejtës për azil

Neni 26

(1) Procedura për njohjen e të drejtës për azil fillon nga momenti i paraqitjes së kërkesës për njohjen e së drejtës për azil nga kërkuesi.

(2) I huaji mund të parashtrorë kërkesë për njohjen e së drejtës për azil në polici në pikën kufitare, stacionin më të afërt të policisë, në Qendrën Pranuese për të Huajt ose në Sektorin për azil.

(3) Nëse kërkesa dorëzohet në polici në pikën kufitare, në stacionin më të afërt të policisë ose në Qendrën e Pranimi për të Huajt, punonjësi i policisë nga paragrafi (1) i këtij neni e shoqëron kërkuesin e të drejtës për azil në Qendrën Pranuese për Azilkërkues.

(4) Kërkuesi i të drejtës për azil, i cili qëndron në territorin e Republikës së Maqedonisë, paraqet kërkesë për njohjen e të drejtës për azil në Sektorin për azil.

(5) Në rastet e bashkimit familjar, kërkesa mund të paraqitet në përfaqësinë diplomatike-konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.

Hyrja dhe qëndrimi i paligjshëm në Republikën e Maqedonisë

Neni 27

Ndaj kërkuesit të së drejtës për azil që ka hyrë paligjshëm ose qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe vjen drejtpërdrejt nga një vend në të cilin jeta ose liria e tij është në rrezik, sipas neneve 5 dhe 9 të këtij ligji, nuk do të veprohet në përputhje me rregullat për të huajt, nëse ai menjëherë shpreh qëllimin ose kërkon njohjen e së drejtës për azil dhe nëse i justifikon shkaqet e arsyeshme për hyrjen ose qëndrimin e paligjshëm të tij.

Mënyra e parashtrimit të kërkesës për njohjen e të drejtës për azil

Neni 28

(1) Kërkesa për njohjen e së drejtës për azil paraqitet me shkrim ose me gojë në procesverbal, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik ose, nëse kjo nuk është e mundur, në gjuhën e vendit të prejardhjes, në ndonjërin nga gjuhëte huaja të pranuar më gjerësisht oise në gjuhën e cila mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se kërkuesi i të drejtës për azil e kupton.

(2) Me paraqitjen e kërkesës për njohjen e së drejtës për azil, azilkërkuesi fotografohet dhe i merren shenjat e gishtërinjve.

(3) Pas marrjes së kërkesës për njohjen e së drejtës për azil në Sektorin për azil, zbatohet bisedë fillestare për regjistrimin e kërkuesit të azilit duke me plotësimin e formularit të përcaktuar.

(4) Me dorëzimin e kërkesës për azil, Sektori për azil në afat prej tri ditësh pune do t'i lëshojë vërtetim kërkuesit të të drejtës për azil me vulë, numrin dhe datën e parashtrimit, me të cilin konfirmohet statusi i azilkërkuesit dhe dëshkohet se azilkërkuesit i lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Maqedonisë derisa të zgjasë procedura për kërkesën e tij për njohjen e së drejtës për azil.

(5) Në rastin e moslëshimit të vërtetimit në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, kërkuesi i të drejtës për azil ka të drejtë të paraqesë kundërshtim në Sektorin për Azil, në afat prej 15 ditëve nga dita e skadimit të afatit.

(6) Për kundërshtimin nga paragrafi (5) i këtij neni vendos udhëheqësi i njësisë organizative të drejtpërdrejtë të lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, fushëveprimi i të cilës është që të vendosë për kundërshtimin, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të kundërshtimit.

(7) Në rast kur njëkohësisht janë parashtruar një numër i madh i kërkesave për njohjen e së drejtës për azil, afati për lëshimin e vërtetimit nga ana e Sektorit për azil i përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, mund të zgjatet për 10 ditë pune.

(8) Sektori për Azil në Ministrinë e Punëve Brendshme do t'i njoftojë me shkrim dhe gojarisht kërkuesit të të drejtës për azil në gjuhën që mund të supozohet se e kuptojnë dhe në afat jo më të gjatë se 15 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për njohjen e të drejtës për azil, për mënyrën e zbatimit të procedurës për njohjen e së drejtës për azil, për të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve të të drejtës për azil në atë procedurë, për pasojat e mundshme në qoftë se nuk u përmbahen obligimeve të tyre dhe nuk bashkëpunojnë me organet kompetente, si dhe në lidhje me kushtet e pranimi, të drejtën për ndihmë ligjore dhe të drejtën për të komunikuar me personat që ofrojnë ndihmë juridike, përfaqësuesit e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë dhe organizatat humanitare joqeveritare, në të gjitha fazat e procedurës dhe kudo që të ndodhen kërkuesit e të drejtës për azil.

Obligimi për dorëzimin e dokumenteve

Neni 29

(1) Nëse kërkuesi i të drejtës për azil ka dokumente, është e nevojshme të njëjtat t'ia bashkëngjisë kërkesës për njohjen e së drejtës për azil kur ato janë të domosdoshme për procedurën e njohjes së së drejtës për azil, dhe veçanërisht:- pasaportën,

- viza, leje për qëndrim ose dokumente tjera të ngjashme,

- letërnjoftim ose dokument tjetër për identifikim,

- certifikatë të lindjes dhe të kurorëzimit,

- biletat e rrugës dhe ngjashëm, si dhe

- dokumente tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme në procedurën e pranimi të kërkesës për azil.

(2) Dokumentet nga paragrafi (1) i këtij neni ruhen në Sektorin për azil gjatë procedurës për pranimin e të drejtës për azil, ndërsa kërkuesit të të drejtës për azil do t'i sigurohet fotokopje e dokumenteve të dorëzuara dhe i jepet vërtetim se dokumentet origjinale i ka në Sektorin për Azil.

Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave

Neni 30

(1) Kërkuesi i të drejtës për azil është i obliguar të paraqesë të gjithë dokumentacionin në dispozicion në afat më të shkurtër të mundshëm dhe të ofrojë informacion në lidhje me moshën, lidhjet familjare, identitetin, shtetësinë, shtetet dhe vendet e banimit të mëparshëm, kërkesat e parashtruara më parë për njohje të së drejtës për azil, marshutat e udhëtimit, dokumentet e identifikimit dhe udhëtimit dhe arsyet për paraqitjen e kërkesës për njohjen e së drejtës për azil.

(2) Kërkesën e parashtruar për pranimin e të drejtës për azil Sektori për azil e shqyrton veçmas, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat që janë relevante për miratimin e vendimit, edhe atë:- të gjitha faktet relevante nga burime të ndryshme, siç është Zyra Evropiane për Përkrahjen e Azilit (EASO) dhe Komisarati i Lartë për Refugjatë në Kombet e Bashkuara (UNHCR) dhe organizatat relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e që kanë të bëjnë me vendin e prejardhjes në kohën e miratimit të vendimit për kërkesën e parashtruar, duke përfshirë edhe ligjet dhe rregullat në vendin e prejardhjes dhe mënyrën në të cilën ato zbatohen,- deklaratat relevante dhe dokumentacionin të dhëna nga kërkuesi i të drejtës për azil, duke përfshirë informacione nëse kërkuesi i të drejtës për azil ka qenë ose ka mundur t'i nënshtrohet përndjekjes ose lëndimeve serioze,- gjendja individuale dhe kushtet personale në të cilat gjendet kërkuesi i të drejtës për azil, duke përfshirë faktorë siç janë origjina, gjinia dhe moshën, në mënyrë që të vlerësohet nëse, në bazë të kushteve personale në të cilat gjendet kërkuesi, aktet në të cilat ka qenë ose do të mund t'u nënshtrohet kërkuesi për të drejtën e azilit, mund të konsiderohen si përndjekje ose lëndime serioze,- nëse aktivitetet e kërkuesit të të drejtës për azil, pas largimit nga vendi i prejardhjes, janë marrë me qëllimin e vetëm për të krijuar kushtet e domosdoshme për të parashtruar kërkesën për pranimin e të drejtës për azil, që të vlerësohet nëse ato aktivitete do ta ekspozojnë ndaj përndjekjes ose lëndimeve serioze, nëse kthehen në atë vend dhe- nëse nga kërkuesi për njohjen e së drejtës për azil mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të pranojë mbrojtje nga një vend tjetër në të cilin do të mund ta marrë shtetësinë.

(3) Në rast se kërkuesi i të drejtës për azil nuk mbështetet në dëshmi të dokumentuara ose në dëshmi të tjera për aspekte të caktuara të deklaratave të tij dhe nuk arsyeton fakte dhe rrethana të caktuara lidhur me kërkesën e tij, deklarata e kërkuesit do të konsiderohet e besueshme, nëse:- kërkuesi i të drejtës për azil ka bërë përpjekje të vërteta për ta mbështetur kërkesën e tij,- janë dorëzuar të gjitha elementet relevante në dispozicion dhe është dhënë një shpjegim i kënaqshëm për mungesën e elementeve të tjera relevante,- është përcaktuar se deklaratat e kërkuesit të së të drejtës për azil janë të qëndrueshme dhe të besueshme dhe të njëjtat nuk janë në kundërshtim me informacionet e disponueshme konkrete dhe të përgjithshme të cilat janë relevante për kërkesën konkrete për njohjen e të drejtës për azil,- kërkuesi i të drejtës për azil ka parashtruar kërkesë për njohjen e së drejtës për azil sa më shpejtë që të jetë e mundur, përveç nëse kërkuesi i të drejtës për azil mund të arsyetojë një shkak të arsyeshëm që nuk e ka bërë të njëjtën dhe - është përcaktuar besueshmëri e përgjithshme e kërkuesit të së drejtës për azil.

E drejta e interpretuesit

Neni 31

(1) Kur kërkuesi i të drejtës për azil nuk e kupton gjuhën e procedurës, Sektori i Azilit atij personi do t'i sigurojë interpretues në gjuhën e vendit të prejardhjes ose në gjuhë që ai e kupton.

(2) Shpenzimet për interpretues i siguron Ministria e Punëve të Brendshme.

(3) Interpretuesi është i obliguar t'i ruajë si sekret të dhënat që i ka mësuar gjatë procedurës.

(4) Kërkuesit e të drejtës për azil me kërkesën e tyre të arsyeshme kanë të drejtë për interpretues të gjinisë së njëjtë, në suaza të mundësive.

Transparenca në procedurë

Neni 32

(1) Gjatë dëgjimit të kërkuesit të së drejtës për azil, opinioni është i përjashtuar.

(2) Me opinion, në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni, nuk konsiderohet personi i cili jep ndihmë juridike i autorizuar nga kërkuesi i të drejtës për azil, kujdestari, interpretuesi dhe përfaqësuesi i Komisarati të Lartë për Refugjatë.(3) Personat nga paragrafi (2) të këtij neni me shkrim do të njoftohen për datën, kohën dhe vendin e dëgjimit.

(4) Personat që marrin pjesë në seancën dëgjimore janë të detyruar të mbajnë sekret të dhënat që kanë mësuar gjatë procedurës, përveç nëse kërkuesi i të drejtës për azil shprehimisht u lejon të komunikojnë me publikun dhe sipas mendimit të personit të autorizuar zyrtar të Sektorit për Azil ajo nuk do të dëmtojë rrjedhën e procedurës.

(5) Sektori për azil mund të ndajë të dhëna lidhur me politikën dhe praktikën në sferën e azilit që janë me rëndësi për hulumtimet shkencore.

Personat e mitur

Neni 33

(1) Për personat e mitur kërkesë për pranimin e të drejtës për azil parashtron prindi ose kujdestari, në pajtim me Ligjin për familje.

(2) Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij ligji, para së gjithash, do të merren parasysh interesat më të mira për fëmijën.

(3) Gjatë vlerësimit të kërkesës për pranimin e të drejtës për azil të fëmijës, medoemos duket të kihet parasysh format e përndjekjes specifike për fëmijë.

Fëmijët e mitur pa shoqërim

Neni 34

(1) Personi i mitur pa shoqërim është i huaji që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç dhe arrin në territorin e Republikës së Maqedonisë pa shoqërimin e prindit ose të kujdestarit ose ka mbetur pa një shoqërim të tillë pasi ka hyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Personave të mitur pa shoqërim, të cilët kanë nevojë për mbrojtje në pajtim me nenin 3 të këtij ligji do t'u caktohet kujdestar, sa më shpejt që të jetë e mundur, në pajtim me Ligjin për familje.

(3) Kujdestarit nga paragrafi (2) i këtij neni i lejohet ta informojë personin e mitur pa shoqërim për rëndësinë dhe pasojat e mundshme të dëgjimit, si dhe të marrë pjesë aktive gjatë seancës së dëgjimit të personit të mitur të pashoqëruar të zbatuar nga ana e personit të autorizuar zyrtar të Sektorit për Azil.

(4) Në përputhje me personin e mitur pa shoqërim, kujdestari ndërmerr masa për gjetjen e anëtarëve të familjes të personit të miturit pa shoqërim.

(5) Interesat më të mira të fëmijës, para së gjithash do të merren parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave për njohjen e së drejtës për azil të personave të mitur pa shoqërim.

(6) Mënyrën e kujdesit dhe akomodimit të personave të mitur pa shoqërim e përcakton ministri për Punë dhe Politikë Sociale.

Personat e cenueshëm

Neni 35

(1) Gjatë zbatimit të këtij ligji, do të merren parasysh nevojat e veçanta të personave të cenueshëm, të cilët janë kërkues të të drejtës për azil, persona me status refugjati, persona nën mbrojtje plotësuese ose persona nën mbrojtje të përkohshme.

(2) Personat e cenueshëm, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, janë persona të paaftë procesual, persona të mitur, persona të mitur pa shoqërim, persona të sëmurë rëndë, persona me pengesa në zhvillim, personat me pengesa trupore, persona të moshuar, gratë shtatzëna, prindër vetëmbajtës me fëmijë të mitur, viktimat të tregtisë me njerëz dhe persona të cilët janë i nënshtruar torturës, përdhunimit ose formave të tjera të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale.

(3) Nevojat e veçanta të personave të cenueshëm nga paragrafi (1) i këtij neni do të përcaktohen me anë të një vlerësimi individual të gjendjes së tyre nga institucioni publik kompetent për mbrojtje sociale.

(4) Gjatë vendosjes dhe plotësimit të standardit të jetesës së personave nga paragrafi (2) i këtij neni do të merret parasysh gjendja e tyre duke ofruar ndihmë adekuate shëndetësore, psikosociale dhe ndihma të tjera.

(5) Është e domosdoshme që gjatë vlerësimit të kërkesës për pranimin e të drejtës për azil të kihet parasysh format e përndjekjes specifike për përkatësinë gjinore.

(6) Mënyrën e kujdesit dhe akomodimit të personave të prekur e përcakton Ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Tërheqja e kërkesës për pranimin e të drejtës për azil

Neni 36

(1) Kërkuesi për pranimin e të drejtës për azil konsiderohet i tërhequr dhe procedura ndërpritet me aktvendim nëse vërtetohet se kërkuesi i të drejtës për azil:

- e ka tërhequr kërkesën për pranimin e të drejtës për azil;

- nuk paraqitet në ftesën për dëgjim në Sektorin për azil, dhe nuk e justifikon mungesën e tij në afat prej pesë ditëve nga dita e dëgjimit të caktuar ose- largohet nga vendi i caktuar për vendosjen e tij pa leje gjatë kohëzgjatjes së procedurës, për më shumë se tri ditë pa e njoftuar organin kompetent ose duke mos dhënë pëlqimin e autoritetit kompetent për largimin nga vendi i caktuar për vendosjen e tij.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkuesi i të drejtës për azil mund të paraqesë padi për nritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(3) Padia e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Dorëzimi

Neni 37

Dokumentet në procedurën për njohjen e së drejtës për azil do t'i dorëzohen personalisht kërkuesit të së drejtës për azil ose prindit ose kujdestarit të tij ose të autorizuarit të tij.

2. PROCEDURA E RREGULLT

Zbatimi i procedurës së rregullt

Neni 38

(1) Procedura e rregullt për njohjen e së drejtës për azil në shkallë të parë kryhet nga Sektori për Azil, i cili është i detyruar ta miratojë vendimin brenda gjashtë muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) i këtij neni, nëse Sektori për Azil nuk mundet, për shkaqe të arsyeshme ta miratojë vendimin brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (1), procedura mund të zgjatet edhe për tre muaj por jo më shumë se nëntë muaj.

(3) Për shkaqe të arsyeshme në kuptimin e paragrafit (2) të këtij neni nënkuptohet:

- nëse duhet të përcaktohen çështje të ndërlikuara faktike ose çështje ligjore lidhur me kërkesën për njohjen e së drejtës për azil, nëse një numër i madh i shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi paraqesin kërkesë njëkohësisht për njohjen e së drejtës për azil, nëse kërkuesi i të drejtës për azil nuk i përmbush detyrat e përcaktuara në nenin 62 të këtij ligji.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) i këtij neni, afati mund të zgjatet edhe për tre muaj me qëllim që të shqyrtohet plotësisht kërkesa për njohjen e të drejtës për azil.

(5) Në rastet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, kërkuesi i të drejtës për azil informohet nga Sektori për Azil për vazhdimin e afatit për miratimin e vendimit dhe me kërkesë të tij do të marrë informacione për arsyet e zgjatjes së procedurës dhe afatin kohor në të cilin duhet të miratohet vendimi.

Dëgjimi i kërkuesit të së drejtës për azil

Neni 39

(1) Para se të miratojë vendim Sektori për Azil, kërkuesi i të drejtës për azil do të ketë mundësi që të dëgjohet personalisht, kurse dëgjimi mund të incizohet edhe me zë, për çfarë do të informohet paraprakisht.

(2) Në rastet kur kërkuesi i të drejtës për azil është person i paaftë procesual, sepse do të zhvillohet në prani të prindit ose kujdestarit dhe përfaqësuesit ligjor.

(3) Dëgjimi i personave të mitur ose i personave të mitur pa shoqërim zbatohet në prani të prindit, respektivisht kujdestarit dhe përfaqësuesit ligjor.

(4) Dëgjimi nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në kushte që mundësojnë besueshmëri të plotë.

(5) Dëgjimi do të zhvillohet pa praninë e anëtarëve të familjes së kërkuesit, përveç nëse personi i autorizuar zyrtar nga Sektori për Azil vlerëson se prania e anëtarëve të tjerë të familjes është e nevojshme për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e së drejtës për azil.

(6) Kërkesit e të drejtës për azil, me kërkesë të tyre të arsyetuar, kanë të drejtë të dëgjohen nga person zyrtar i autorizuar i Sektorit për Azil të të njëjtës gjini në kuadër të mundësive.

(7) Personi i autorizuar zyrtar i cili e udhëheq seancën dëgjimore është profesionist që t'i marrë parasysh rrethanat personale ose të përgjithshme në të cilat ndodhet kërkuesi, të cilat kanë të bëjnë me kërkesën për njohjen e së drejtës për azil, duke përfshirë origjinën kulturore ose cenusshmërinë e kërkuetit, në kuadër të mundësive.

(8) Personi i autorizuar zyrtar i cili e mban seancën dëgjimore me qëllim për realizimin e një komunikimi adekuat siguron interpretues. Në rastet kur komunikimi nuk është i mundur në gjuhën në të cilën dëshiron kërkuesi i të drejtës për azil, atëherë dëgjimi do të zhvillohet në një gjuhë që mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se kërkuesi i të drejtës për azil e kupton dhe mund të komunikojë.

(9) Gjatë dëgjimit, kërkuesi i të drejtës për azil i paraqet të gjitha faktet dhe dëshmitë me rëndësi për përcaktimin e ekzistencës së një frike të përcaktuar për përndjekjem, në kuptim të nenit 5 të këtij ligji ose lëndime serioze në kuptim të nenit 9 të këtij ligji.

(10) Gjatë seancës dëgjimore mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë personat të cilët marrin pjesë në seancën dëgjimore. Në rastet kur kërkuesi i të drejtës për azil nuk pajtohet me përmbajtjen në procesverbalin e seancës dëgjimore dhe refuzon ta nënshkruaj, i njëjti evidentohet në lëndën e kërkuetit.

(11) Personi i autorizuar zyrtar kur vendos në procedurën për njohjen e së drejtës për azil, gjithashtu mund ta marrë parasysh faktin që kërkuesi për njohjen e së drejtës për azil nuk ka arritur të paraqitet në seancën dëgjimore, përveç se në rastet kur ka shkaqe të arsyeshme që ta arsyetojë mungesën e tij.

Shqyrtimi në bazë të pranimit të të drejtës për azil për shkak të së drejtës subsidiare

Neni 40

Në rastet kur vërtetohet se kërkuesi i të drejtës për azil nuk i plotëson kushtet për njohjen e së drejtës për azil, për personin me status të refugjatit në pajtim me nenin 3 alineja 1 të këtij ligji, Sektori për Azil me detyrë zyrtare do të shqyrtojë ekzistencën e arsyeve dhe kushtet për njohjen e së drejtës për azil për mbrojtje plotësuese, në pajtim me nenin 3 alineja 2 të këtij ligji.

Shkaqet e refuzimit

Neni 41

Kërkesa e kërkesës për të drejtë për azil do të refuzohet në procedurën e rregullt kur do të përcaktohet se:

- nuk ekziston frikë e arsyeshme e përndjekje në kuptimin e nenit 5 të këtij ligji;
- nuk ekzistojnë rreziqe për lëndime serioze në kuptimin e nenit 9 të këtij ligji;
- ekzistojnë shkaqe për përjashtimin e neneve 8 dhe 10 të këtij ligji dhe

- përndjekja për shkaqet nga neni 5 i këtij ligji dhe rreziqet e shkaktoimit të lëndimeve serioze nga neni 9 i këtij ligji, kufizohet vetëm në një zonë gjeografike të caktuar të shtetit shtetas i së cilës është personi, ose nëse është pa shtetësi, në të cilin ka pasur një vend të zakonshëm qëndrimi, dhe ekziston mundësia për mbrojtje efikase në një pjesë tjetër të shtetit, përveç nëse, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat nuk mund të pritët që personi të kërkojë mbrojtje atje.

Miratimi dhe llojet e aktvendimeve

Neni 42

(1) Në bazë të fakteve dhe dëshmime të përcaktuara në procedurë, Sektori për Azil do të miratojë me shkrim një vendim për njohjen e statusit të refugjatit, aktvendimin për njohjen e statusit të personit nën mbrojtje plotësuese ose aktvendimin që refuzon kërkesën për njohjen e së drejtës për azil.

(2) Në bazë të fakteve dhe dëshmime të përcaktuara në procedurë, nëse të dy prindërit kanë fituar statusin e refugjatit ose të person nën mbrojtje subsidiare, Sektori për Azil gjithashtu mund të miratojë aktvendim që njeh të njëjtin status të fëmijës së tyre të mitur që ka lindur dhe jeton në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Në rast kur njëri prind ka fituar statusin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, Sektori për Azil mund të miratojë aktvendim për fëmijën e mitur që ka lindur dhe jeton në territorin e Republikës së Maqedonisë me të cilin pranohet e drejta për azil, statusi refugjat ose mbrojtje subsidiare.

(4) Aktvendimi me të cilin refuzohet kërkesa për njohjen e së drejtës për azil i përmban shkaqet për të të cilat nuk është pranuar kërkesa dhe udhëzimi për mjet juridik.

E drejta për padi dhe miratimi i vendimit

Neni 43

(1) Kërkuesi i të drejtës për azil mund të ngrejë kontest administrativ kundër vendimit të Sektorit për Azil në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(2) Padia e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(3) Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Kërkesa e sërishme për pranimin e të drejtës për azil

Neni 44

I huaji mund të paraqesë kërkesë të sërishme për njohjen e së drejtës për azil, në rast se lindi rrethana të reja, respektivisht rrethanat kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme ose kërkuesi ka paraqitur dëshmi të reja nga momenti i miratimit të aktvendimit përmbarues me të cilin paraprakisht është hedhur poshtë kërkesa e tij.

3. PROCEDURA URGJENTE

Qëllimi i procedurës

Neni 45

(1) Procedura urgjente zbatohet kur kërkesa për njohjen e së drejtës për azil është e palejuar ose qartazi e pabazuar, përveç nëse kërkesa është parashtruar nga një person i

mitur pa shoqërim dhe nga një person me pengesa në zhvillimin mental, si dhe persona për të cilët ka prova ose indicie serioze që i janë nënshtruar torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale.

(2) Për personat nga paragrafi (1) i këtij neni, Sektori për Azil zbaton dëgjim, në pajtim me nenin 39 të këtij ligji.

Kërkesa të palejuara

Neni 46

Kërkesa për njohje të së drejtës për azil llogaritet se është e palejuar, nëse:

- personi ka arritur nga vend i sigurt i tretë, ku ka mundur të kërkojë njohje të së drejtës për azil, përveç nëse ka kontestuar se vendi i tretë është i sigurt për të,
- ka fituar të drejtën e azilit në vend tjetër dhe vazhdon ta gëzojë mbrojtjen e atij vendi ose
- pas dorëzimit të kërkesës së sërishme për njohje të së drejtës për azil është përcaktuar se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 44 të këtij ligji.

Kërkesa të pabazuara evidente

Neni 47

Kërkesa për njohje të së drejtës për azil llogaritet se është e pabazuar evidente, në rast se:

- nuk ka bazë në pretendimin për frikë nga ndjekja, sepse kërkesa nuk është parashtruar për arsye të përcaktuara me këtë ligj, por për shkak të mundësisë së punësimit dhe kushteve më të mira për jetë, ose kur aplikuesi nuk jep të dhëna se do t'i nënshtrohet ndjekjes ose kur pretendimet e tij janë të pamundura ose kundërtshënese,
- kërkesa bazohet në mashtrim të sajuar ose keqpërdorim të procedurës për njohje të së drejtës për azil,
- personi ka arritur nga vend i sigurt të prejardhjes, përveç nëse konteston se vendi i prejardhjes është i sigurt për të,
- personi ka arritur nga vend i sigurt i prejardhjes, i cili është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, përveç nëse konteston se vendi i prejardhjes është i sigurt për të,
- pa shpjegim të arsyeshëm, me qëllim jep deklarata të pavërteta në kërkesën e tij për njohjen e së drejtës për azil, qoftë me gojë ose formë të shkruar, kurse këto deklarata janë të natyrës dhe rëndësisë thelbësore për përcaktimin e statusit të tij,
- pa sqarim të arsyeshëm, e ka bazuar kërkesën e tij mbi identitet të rrejshëm ose mbi dokumenteve të falsifikuara, për të cilët pohon se janë autentike,
- qëllimisht asgjëson, dëmton ose fsheh dokument të udhëtimit, dokument ose dëshmi tjetër me rëndësi për procedurën, me qëllim ta pengojë rrjedhën e procedurës dhe të sjellë në huti organet për njohjen e së drejtës për azil në lidhje me identitetin e tij,
- kërkesa për njohjen e së drejtës së azilit është parashtruar për të parandaluar zbatimin e vendimit për dëbim nga territori i Republikës së Maqedonisë, dhe kërkesi ka pasur mundësi të mjaftueshme paraprakisht për të kërkuar njohje të së drejtës për azil ose

- kërkesa për njohjen e së drejtës për azil të personit i është refuzuar në vend tjetër, pas shqyrtimit të thelbit të kërkesës, në procedurë që i ka përmbajtur garancitë e duhura procedurale, në përputhje me Konventën e Gjenevës, përveç kur janë paraqitur rrethanat e reja, domethënë rrethanat në bazë të të cilave i është refuzuar kërkesa në vend tjetër qenësisht janë ndryshuar.

Miratimi i aktvendimit

Neni 48

(1) Në rastet kur kërkesa për njohjen e së drejtës për azil konsiderohet e papranueshme ose e pabazuar evidente, Sektori për Azil miraton aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për njohjen e së drejtës për azil.

(2) Në arsyetimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni theksohen shkaqet për refuzim të kërkesës për azil.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) të këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për njohjen e së drejtës për azil.

Padia kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa

Neni 49

(1) Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për njohjen e së drejtës për azil në procedurë urgjente kërkesi i së drejtës së azilit ka të drejtë të padisë për ngritje të kontestit administrativ në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(2) Padia nga paragrafi (1) i këtij neni e prolongon realizimin e aktvendimit.

(3) Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

KAPITULLI III

PUSHIMI, ANULIMI DHE HEQJA E TË DREJTËS SË AZILIT

Pushimi i të drejtës të azilit

Neni 50

(1) E drejta e statusit të refugjatit e pranuar në Republikës së Maqedonisë pushon për person i cili:

- vullnetarisht përsëri është vendosur nën mbrojtjen e vendit shtetas i të cilit është,
- pasi e ka humbur shtetësinë e tij, vullnetarisht përsëri e ka fituar,
- ka fituar shtetësi të re dhe gëzon mbrojtje nga shteti i shtetësisë së tij të re,
- vullnetarisht përsëri është shpërngulur në shtetin që e ka braktisur ose ka ngelur jashtë nga ai për shkak të frikës nga ndjekja,
- nuk mund më tej të vazhdojë të refuzojë të përdorë mbrojtjen nga vendi ku është shtetas, pasi që rrethanat për shkak të të cilave personit i është pranuar e drejta për azil kanë pushuar të ekzistojnë ose
- është pa nënshtetësi dhe mund të kthehet në shtetin e vendqëndrimi të tij të zakonshëm, pasi që rrethanat për të cilat personit i është pranuar e drejta për azil kanë pushuar të ekzistojnë.

(2) Përveç rasteve nga paragrafi (1) i këtij neni, statusi i personit nën mbrojtje plotësuese pushon edhe në rast kur kushtet ndaj të cilëve është miratuar statusi, më tej nuk ekzistojnë ose kanë ndryshuar në një shkallë të tillë që mbrojtja e tillë nuk është më e nevojshme .

(3) Gjatë vlerësimit të ekzistencës së rasteve nga paragrafi (1), paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni, do të merren parasysh nëse ndryshimi në kushtet është natyrë e rëndësishme dhe nuk është i përkohshëm, për frikën nga ndjekja e personit me status refugjat më tej të mos konsiderohet i bazuar në mënyrë të arsyeshme.

(4) Dispozitat nga paragrafit (1), alinetë 5 dhe 6 të këtij neni, nuk zbatohen për personin me status të refugjatit, i cili mund të tregojë arsye bindëse që dalin nga ndjekje e mëparshme, për refuzimin e tij ta shfrytëzojë mbrojtjen e shtetit shtetas i të cilit është, ose në rastin e personit pa shtetësi, në vendqëndrimin e tij të zakonshëm paraprak .

(5) Për ndërprerje të së drejtës së azilit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurën për njohjen e së drejtës për azil.

Shfuqizimi dhe heqja e statusit të refugjatit

Neni 51

(1) Statusi i refugjatit shfuqizohet nëse përcaktohet se:

- kanë ekzistuar shkaqe për përjashtim nga neni 8 i këtij ligji para pranimit të të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë ose

- statusi është fituar me shtrembërim ose fshehje të fakteve duke përfshirë përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, ndërsa të cilat ishin me rëndësi vendimmarrëse për marrje të statusit refugjat.

(2) Sektori për Azil, i cili ka marrë vendimin me të cilin personit i është njohur statusi i refugjatit, në bazë individuale, përcakton nëse personi ka pushuar të jetë ose asnjëherë nuk ka qenë refugjat, pa qenë kjo në kundërshtim me detyrimin e refugjatit për ta paraqitur dokumentacionin e plotë në dispozicion.

(3) Statusi i refugjatit hiqet nëse përcaktohet se:

- kanë ndodhur arsye për përjashtim nga neni 8 i këtij ligji,

- personi paraqet rrezik për sigurinë e shtetit ose

- personi është i dënuar për vepër të rëndë penale posaçërisht me vendim të prerë dhe paraqet rrezik për vendin.

(4) Për shfuqizimin dhe heqjen e statusit të refugjatit nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga ky ligj që kanë të bëjnë me procedurën për njohjen e të drejtës për azil .

Shfuqizimi dhe heqja e statusit të personit nën mbrojtje subsidiare

Neni 52

(1) Statusi i personit nën mbrojtje subsidiare shfuqizohet nëse përcaktohet se:

- kanë ekzistuar shkaqe për përjashtim nga neni 10 i këtij ligji para njohjes së të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë,

- statusi është fituar me shtrembërim ose fshehje të fakteve duke përfshirë përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, kurse të cilat kanë qenë vendimtare për marrjen e statusit të personit nën mbrojtje subsidiare.

(2) Sektori për Azil, i cili ka marrë vendimin me të cilin një personi i është njohur statusi i personit nën mbrojtje subsidiare, në bazë individuale, përcakton nëse personi pushon të jetë ose asnjëherë nuk ka qenë person nën mbrojtje subsidiare, pa qenë kjo në kundërshtim me detyrimin e personit nën mbrojtje subsidiare për ta paraqitur dokumentacionin e plotë në dispozicion.

(3) Statusi i personit nën mbrojtje subsidiare shfuqizohet nëse përcaktohet se:

- kanë ndodhur shkaqe për përjashtim nga neni 10 i këtij ligji,

- personi paraqet rrezik për bashkësinë ose sigurinë e shtetit ose

- personi ka kryer vepër penale para se të hyjë në vendin në të cilin është e dënueshme me burg, derisa shkak për lëshim të vendit të prejardhjes ishte vetëm që të shmanget dënimi i përcaktuar në legjislacionin nacional në atë vend.

(4) Për shfuqizimin dhe heqjen e statusit të personit nën mbrojtje subsidiare nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurën për njohjen e të drejtës për azil.

KAPITULLI IV

DOKUMENTET

Lëshimi i dokumenteve

Neni 53

(1) Dokumente, në kuptim të këtij ligji, llogariten:

- dokumente të identifikimit për kërkues së të drejtës për azil,

- letërnjoftimi për person me status të refugjatit dhe për person nën mbrojtje subsidiare dhe

- dokument udhëtimi për person me status të refugjatit, në pajtim me Konventën e Gjenevës.

(2) Personit nën mbrojtje subsidiare i lëshohet dokument udhëtimi në pajtim me dispozitat për të huajt.

(3) Dokumentet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, në pajtim me këtë ligj, i lëshon Ministria e Punëve të Brendshme.

(4) Dokumenti nga paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij neni është dokument identifikimi të cilin personi është i detyruar të mbajë me vete dhe ta tregojë me kërkesë të personit zyrtar i cili me ligj është i autorizuar të legjitimojë.

(5) Është e ndaluar t'i jepet dokumenti nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni për përdorim dikujt tjetër ose personi të shërbehet me dokument të huaj si me të vetin.

Dokument identifikimi për kërkues të të drejtës për azil

Neni 54

(1) Kërkuesit të të drejtës për azil do t'i lëshohet dokument identifikimi në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për njohje të të drejtës për azil.

(2) Dokumenti i identifikimit për kërkuesit e të drejtës për azil është me rëndësi deri në marrjen e vendimit përfundimtar në procedurën për azil përkatësisht deri në skadimin e afatit në të cilin personi është i detyruar të lëshojë territorin e Republikës së Maqedonisë pas plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është refuzuar kërkesa e tij.

(3) Me dokument identifikimi nga paragrafi (1) i këtij neni vërtetohet e drejta e qëndrimit të kërkuesit të të drejtës për azil në afatin për vlefshmërinë e dokumentit të identifikimit të përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni.

Letërnjoftimi

Neni 55

(1) Personi me status refugjat dhe personi nën mbrojtje subsidiare, i cili ka mbushur 18 vjet është i detyruar të paraqesë kërkesë për lëshim të letërnjoftimit.

(2) Letërnjoftimi mund t'i lëshohet edhe personit me status të refugjatit dhe personit nën mbrojtje subsidiare me mbushjen e moshës 15 vjeçare, me kërkesën e tij personale, me pëlqimin paraprak nga prindi ose kujdestari.

(3) Letërnjoftimi për person me status të refugjatit lëshohet me afat të vlefshmërisë prej së paku tre vjet dhe vazhdohet, përveç nëse kjo nuk është e mundur për shkak të arsyeve të lidhura me sigurinë nacionale ose me rendin publik.

(4) Letërnjoftimi për person nën mbrojtje subsidiare, lëshohet me afat të vlefshmërisë prej të paktën një viti dhe vazhdohet për të paktën dy vjet, përveç nëse kjo nuk është e mundur për shkaqe të lidhura me sigurinë nacionale ose me rendin publik.

(5) Me letërnjoftimin për person me status të refugjatit dhe person nën mbrojtje subsidiare vërtetohet e drejta e qëndrimit.

(6) Personit me status të refugjatit dhe personit nën mbrojtje subsidiare i caktohet numër i amzës për të huaj.

Dokument udhëtimi

Neni 56

(1) Personit me status të refugjatit dokumenti i udhëtimit i lëshohet me vlefshmëri prej dy vitesh. Dokumenti i udhëtimit personit me status të refugjatit i lëshohet me kërkesë personale, përveç për person me status të refugjatit më të ri se 18 vjet, për të cilin kërkesa për lëshimin e dokumentit të udhëtimit e parashton prindi i tij ose kujdestari.

(2) Me lëshimin e dokumentit të udhëtimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi me status të refugjatit sipas rregullit nuk do të pajiset me të drejtën për të marrë ndihmë nga përfaqësitë diplomatike - konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.

(3) Me kërkesë të personit nën mbrojtje subsidiare i lëshohet dokument udhëtimi në pajtim me dispozitat për të huaj.

Refuzim për lëshim dhe marrje të dokumentit të udhëtimit

Neni 57

(1) Dokument udhëtimi nuk do t'i lëshohet personit me status të refugjatit:

- kundër të cilit mbahet procedurë penale ose kundërvajtëse, me kërkesë nga gjykata kompetente,
- të cilit i është shqiptuar dënim me burg pa kusht, derisa nuk e vuan dënimin dhe
- në kërkesë të organit kompetent, derisa nuk i ka shlyer detyrimet juridike pronësore ose detyrimet financiare ndaj Republikës së Maqedonisë.

(2) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni kanë ekzistuar para ditës së lëshimit të dokumentit të udhëtimit, kurse për to është zbuluar më vonë ose arsyet kanë ndodhur pas ditës së lëshimit, dokumenti i udhëtimit do të merret.

(3) Në aktvendimin me të cilin refuzohet kërkesa për lëshim të dokumentit të udhëtimit, përkatësisht merret dokumenti i udhëtimit, theksohen shkaqet.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni mund të ngritet kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(5) Padia kundër aktvendimit për marrje të dokumentit të udhëtimit nuk e prolongon përmbardimin e tij.

(6) Për refuzim të dhënies ose marrjes së dokumentit të udhëtimit për të huaj për personat nën mbrojtje subsidiare, zbatohen dispozitat për të huaj.

Kthimi i dokumenteve

Neni 58

(1) Pas plotfuqishmërisë së vendimit për refuzimin e kërkesës për njohjen e të drejtës për azil, pushimit, shfuqizimit ose heqjes së të drejtës për azil, personi është i detyruar t'i kthejë dokumentet e lëshuara.

(2) Kërkuesi i të drejtës për azil i cili ka dorëzuar kërkesë për tërheqje në pajtim me nenin 36 të këtij ligji, me kërkesë është i detyruar të kthejë dokumentet që i ka lëshuara Ministria e Punëve të Brendshme.

Humbja ose dëmtimi i dokumenteve

Neni 59

(1) Personi të cilit i është lëshuar dokument në pajtim me këtë ligj, është i detyruar në afat prej dy ditësh, nga dita kur ka kuptuar se dokumenti është humbur ose dëmtuar, ta paraqesë humbjen e tij ose dëmtimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(2) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni në Sektorin për azil do të dorëzojë deklaratë me shkrim për kohën, vendin dhe mënyrën në të cilën dokumenti është humbur ose dëmtuar.

KAPITULLI V**POZITA JURIDIKE****Detyrime të përgjithshme**

Neni 60

(1) Çdo kërkues i të drejtës për azil ose person të cilit i është pranuar e drejta e azilit në Republikën e Maqedonisë, gjatë qëndrimit në Republikën e Maqedonisë, është i obliguar t'i përmbahet Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ligjeve, dispozitave tjera dhe vendimeve të organeve shtetërore, si dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(2) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me qëllim që të lehtësojë integrimin e kërkuesit të të drejtës për azil ose personave të cilëve u është pranuar e drejta e azilit në Republikën e Maqedonisë përgatit programe për integrim.

1. TË DREJTA DHE DETYRIME TË KËRKUESVE TË TË DREJTËS PËR AZIL**Të drejta të kërkuesve të të drejtës për azil**

Neni 61

(1) Kërkuesit e së drejtës për azil deri në miratimin e vendimit përfundimtar në procedurë për njohje të të drejtës për azil kanë të drejtë të:

- qëndrimin,
- dokumentit të identifikimit,
- lirisë së lëvizjes,
- ndihmës juridike falas,
- vendosjes përkatëse dhe kujdesit në Qendrën e Pranimit ose vend tjetër për vendosje të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, derisa tregon nevojë për të,
 - unitetit familjar,
 - shërbimeve shëndetësore themelore me dispozitat për sigurim shëndetësor,
 - të drejtës së mbrojtjes sociale me dispozitat për mbrojtje sociale,
 - të drejtën e arsimimit në pajtim me dispozitat për arsimin fillor dhe të mesëm,
 - punës vetëm në korniza të Qendrës së Pranimit ose vendit tjetër për vendosje të caktuara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe të drejtë të qasjes së lirë në tregun e punës për kërkuesin e së drejtës për azil për të cilën kërkesa për njohjen e së drejtës për azil nuk është marrë vendim nga Sektori për Azil, për periudhë jo më të gjatë se nëntë muaj pas parashtrimit të kërkesës,
 - qasjes te programe të arritshme për integrim të hershëm dhe
 - kontakteve me Komisaratin e Lartë për Refugjatë, si dhe organizatat humanitare joqeveritare për shkak dhënies së ndihmës juridike në procedurën për njohjen e të drejtës për azil.

(2) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për të drejtat të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni i njofton kërkuesit e të drejtës për azil me shkrim në gjuhën për të cilën arsyeshëm mund të supozohet se e kuptojnë ose me gojë me ndihmën e interpretuesit.

(3) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kujdeset për sigurimin e mjeteve për mbajtje dhe sigurimin shëndetësor të kërkuesve të të drejtës për azil, derisa gjenden në Qendrën e Pranimit ose vend tjetër për akomodim nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(4) Standardet për pranim të kërkuesve të të drejtës për azil, i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Detyrimet e kërkuesve të të drejtës për azil

Neni 62

- (1) Kërkuesi i të drejtës për azil është i detyruar:
- të qëndrojë në Qendrën e Pranimit ose vend tjetër për vendosje të caktuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe të mos e lëshojë vendin e qëndrimit të caktuar nga organi kompetent pa e informuar për atë ose pa pasur leje për lëshimin e të njëjtit, nëse ajo është e nevojshme,
 - të bashkëpunojë me organet për njohjen e të drejtës për azil, në veçanti të japë të dhëna personale, të dorëzojë dokumentet e identifikimit dhe dokumentet tjera që ai mund të posedojë, të mundësojë fotografimin e tij dhe marrjen e shenjave të gishtërinjve, kontrollin personal dhe kontrollin e bagazhit dhe automjetin me të cilën ka arritur në Republikën e Maqedonisë, si dhe të japë të dhëna për pronën e vet dhe të ardhurat,
 - t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor, mjekimit dhe vaksinimit të lëshuar me kërkesë të organeve kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë, në rast rreziku për shëndetin e njerëzve dhe
 - të respektojë rregullat shtëpiake të Qendrës së Pranimit ose vend tjetër për vendosje të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe të mos tregojë sjellje të dhunshme.

(2) Nëse kërkuesi i të drejtës për azil bën shkelje të rëndë të dispozitave nga paragrafi (1) alineja 4 të këtij neni, si dhe nëse tregon sjellje të dhunshme, organi kompetent mund të marrë aktvendim për heqjen e të drejtës të vendosjes në Qendrën e Pranimit, përkatësisht kompensim të dëmit që kërkuesi i azilit e ka kryer. Organi kompetent aktvendimin e miraton për secilin rast në mënyrë individuale dhe objektive, duke theksuar arsyet për të njëjtën, për të cilat kërkuesi i të drejtës për azil ka të drejtë ankese në pajtim me dispozitat për mbrojtjen sociale. Ankesa e prolongon realizimin e aktvendimit.

(3) Kërkuesi i të drejtës për azil gjatë kohës së qëndrimit të tij në Qendrën e Pranimit mund të parashtror kërkesë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të qëndrojë jashtë nga Qendra e Pranimit me shpenzim personal, pas fotografimit të kryer dhe marrjes së shenjave të gishtërinjve.

(4) Kërkuesit e të drejtës për azil, të cilëve u është miratuar të qëndrojnë jashtë Qendrës së Pranimit ose vend tjetër të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, janë të detyruar para Sektorit për Azil ta paraqesin adresën e tyre në afat prej tri ditëve nga dita e miratimit të dorëzuar për qëndrim jashtë Qendrës së Pranimit.

Kufizimi i lirisë së lëvizjes

Neni 63

(1) Kërkuesit të të drejtës për azil në raste të jashtëzakonshme mund t'i kufizohet liria e lëvizjes, nëse masa të tjera më pak imponuese alternative në pajtim me legjislacionin nacional (marrje të dokumenteve të identifikimit, paraqitje të rregullt) nuk mund të zbatohen në mënyrë efektive.

(2) Rastet e jashtëzakonshme nga paragrafi (1) i këtij neni veçmas janë:

- përcaktim dhe kontroll i identitetit dhe shtetësisë,
- përcaktimi i fakteve dhe rrethanave në bazë të të cilave është paraqitur kërkesa për të drejtë azili kurse të cilat nuk mund të përcaktohet pa kufizim të lëvizjes, veçanërisht nëse vlerësohet se ekziston rreziku për arratisje,

- mbrojtja e rendit publik ose siguria nacionale ose
- mbajtjen e të huajt për shkak të procedurës në pajtim me dispozitat për të huajt për kthimin e të huajve që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vend, me qëllim që të përgatitet kthim ose të zbatohet procesi i largimit, kurse tashmë kanë pasur qasje në procedurën për njohjen e të drejtës për azil, kurse ekziston bazë e arsyeshme të besohet se ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare me qëllim të prolongohet ose të pengohet realizimi i vendimit për kthim.

(3) Rreziku për arratisje të kërkuesit të të drejtës për azil vlerësohet në bazë të fakteve dhe rrethanave për rast konkret, sidomos duke marrë parasysh përpjekjet e mëparshme për lëshimin vullnetar të Republikës së Maqedonisë, refuzim për të verifikuar dhe vërtetuar identitetin e tij, paraqitjen e të dhënave të rrejshme për identitetin dhe shtetësinë e tij.

Masa për kufizim të lirisë së lëvizjes

Neni 64

(1) Liria e lëvizjes nga neni 63 i këtij ligji mund të kufizohet me këto masa:

- ndalim i lëvizjes jashtë nga Qendra e Pranimit për Azilkërkuesit ose vend tjetër për vendosje të përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ose
- vendosje në Qendrën e Pranimit për të Huajt.

(2) Masat për kufizimin e lirisë së lëvizjes nga paragrafi (1) i këtij neni shqiptohen më së voni deri në tre muaj, nga dita kur është dorëzuar aktvendimi me të cilin është shqiptuar masë kufizim i lirisë së lëvizjes, kurse me përjashtim, nëse ende ekzistojnë arsye për shqiptimin e tyre mund të vazhdohen më së shumti edhe tre muaj.

(3) Mënyra e kufizimit të lirisë së lëvizjes së kërkuesit të të drejtës për azil e përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

Organi i cili miraton vendime për kufizim të lirisë së lëvizjes

Neni 65

(1) Ministria e Punëve të Brendshme miraton aktvendim për shqiptimin e masës për kufizimin e lëvizjes së kërkuesit të të drejtës për azil për të cilin përcaktohet afati i zgjatjes së masës.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkuesi i të drejtës për azil ka të drejtë të parashtrijë ankesë në gjykatën kompetente në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(3) Padia nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

(4) Procedura në gjykatën kompetente është urgjente.

Të drejta të kërkuesit të të drejtës për azil gjatë kufizimit të lirisë së lëvizjes

Neni 66

(1) Kërkuesi i të drejtës për azil të cilit i është shqiptuar masë kufizim i lirisë së lëvizjes ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën për të cilën logjikisht mund të supozohet se kërkuesi i të drejtës për azil e kupton, për të drejtën për padë dhe realizimin e të drejtës për ndihmë juridike falas.

(2) Për personat e prekur dhe personat e mitur pa shoqërim vendosje në Qendrën e Pranimit për të Huajt zbatohet vetëm në bazë të vlerësimit individual, si dhe pëlqimin paraprak nga prindi përkatësisht kujdestari i përcaktuar ligjor, se vendosja e tillë përgjigjet në nevojat dhe rrethanat e tyre personale dhe të posaçme, duke marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore.

(3) Me akt të Qendrës së Pranimit për të Huajt rregullohet vendosja e personave të mitur pa shoqërim dhe personave të prekur.

2. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PERSONIT ME STATUS TË REFUGJATIT

Statusi personal dhe e drejta e qëndrimit

Neni 67

Personi me status të refugjatit ka të drejtë të qëndrimit në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Të drejtat dhe detyrimet

Neni 68

(1) Nëse me këtë ose me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe, personat me status të refugjatit kanë të drejta të njëjta dhe detyrime me shtetasit e Republikës së Maqedonisë, me këto përjashtime:

- nuk kanë të drejtë zgjedhore,
- nuk mund të kryejnë aktivitete, të krijojnë marrëdhënie pune dhe të krijojnë shoqata apo parti politike, në rastet kur me ligj si kusht është paraparë personi të ketë shtetësi të Republikës së Maqedonisë.

(2) Personat me status të refugjatit mund të fitojnë të drejtën e posedimit të pronës së tundshme dhe të patundshme, të krijojnë marrëdhënie pune ose të kryejnë veprimtari, nën kushte të përcaktuara me ligj me të cilin rregullohet kjo e drejtë për të huajt në Republikën e Maqedonisë.

Vendosja

Neni 69

(1) Personit me status të refugjatit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i sigurohet vendosje, përmes dhënies së banesës adekuate për shfrytëzim ose ndihmë me para të nevojshme për sigurimin e lokaleve për vendosje, deri në sigurimin e mjeteve për ekzistencën e vet në periudhën jo më shumë se dy vjet pas marrjes së statusit të refugjatit, kurse nëse personi merr pjesë në mënyrë aktive në procesin e integritit, kjo periudhë mund të zgjatet në përputhje me programin për integrim.

(2) Në rast kur personi me status refugjati do të refuzojë lokalitetin e dhëna për vendosje nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ose nëse personi në periudhë prej dy vjetësh nuk është i përfshirë në mënyrë aktive në programet për integrim, e humb të drejtën e vendosjes dhe mund të vendosen në vend tjetër sipas zgjedhjes dhe shpenzimeve personale.

(3) Ministri i Punës dhe Politikës Sociale i përcakton kriteret më të afërta dhe mënyrën e përdorimit të banesës përkatëse për vendosje ose ndihmën me para të nevojshme për sigurimin e lokaleve për vendosje të personave me status të refugjatit në përputhje me nevojat e tyre.

Parimi i pjesëmarrjes lokale

Neni 70

Parimi i pjesëmarrjes lokale nënkupton detyrimin e njësisë të vetëqeverisjes lokale të pranojnë përgjegjësinë për vendosje të personave me status të refugjatit dhe personave nën mbrojtje subsidiare në varësi të zhvillimit ekonomik dhe numrit të banorëve të njësisë të vetëqeverisjes lokale, për çka vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria).

Të drejta nga mbrojtja sociale

Neni 71

Personi me status të refugjatit nga dita e paraqitjes së aktvendimit për njohjen e statusit të refugjatit barazohet me shtetasit e Republikës së Maqedonisë në raport të realizimit të të drejtave nga mbrojtja sociale të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje sociale.

Mbrojtja shëndetësore

Neni 72

Deri në arritjen e cilësisë së personit të siguar në pajtim me Ligjin për sigurimin shëndetësor, personi me status të refugjatit ka të drejtë të mbrojtjes shëndetësore, nën të njëjtat kushte si dhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

Të drejta nga marrëdhënia e punës dhe sigurimi social

Neni 73

(1) Të drejtën e punës personat me status të refugjatit e realizojnë në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat për punësim dhe punë të huajve.

(2) Në pikëpamje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, shëndetësisë, sigurimit pensional dhe invalidor, personat me status të refugjatit janë të barabartë me shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

Burime të financimit dhe organi kompetent që kujdeset për realizimin e të drejtave

Neni 74

(1) Mjetet për vendosje, mbrojtje sociale dhe mbrojtje shëndetësore nga nenet 35, 69, 71, 72, dhe 73 të këtij ligji sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Për vendosje dhe realizim të të drejtave nga mbrojtja sociale dhe mbrojtja shëndetësore nga nenet 35, 69, 71, 72 dhe 73 të këtij ligji kujdeset Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Transferi i pronës, kapitali i investuar dhe fitimi

Neni 75

Në përputhje me dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë, personi me status të refugjatit ka të drejtë të transfertit të pronës që është futur në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe bartje të lirë të kapitalit të investuar dhe fitimin në shtet tjetër ku është pranuar për shkak të popullimit të ri.

3. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PERSONAVE NËN MBROJTJE SUBSIDIARE

Statusi personal dhe e drejta e qëndrimit

Neni 76

Personi nën mbrojtjen subsidiare ka të drejtë të qëndrimit në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Të drejtat dhe detyrimet

Neni 77

(1) Personi nën mbrojtje subsidiare nga dita e dorëzimit të aktvendimit për pranimin e statusit të personit nën mbrojtje subsidiare barazohet me shtetasit e Republikës së Maqedonisë në lidhje me realizimin e të drejtave të mbrojtjes sociale e përcaktuar me Ligjin për mbrojtje sociale, ndërsa e drejta e mbrojtjes sociale me Ligjin për mbrojtje sociale, ndërsa të drejtën e mbrojtjes shëndetësore e realizon në pajtim me nenin 72 të këtij ligji.

(2) Personat nën mbrojtje subsidiare kanë të drejta dhe obligime të njëjta me palët me qëndrim të përkohshëm të lejuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, nëse me këtë ligj ose ligj tjetër nuk është caktuar ndryshe.

Vendosja

Neni 78

Personit nën mbrojtje subsidiare i sigurohet vendosje në pajtim me nenin 69 të këtij ligji.

KAPITULLI VI**LËSHIMI VULLNETAR DHE RIATDHESIMI VULLNETAR****Lëshimi vullnetar**

Neni 79

(1) Pas aktvendimit të plotfuqishëm me të cilin një personi i është refuzuar, anuluar, hequr ose pushuar e drejta e azilit në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori i Azilit me shkrim do ta njoftojë personin për afatin në të cilin është i detyruar në mënyrë vullnetare ta lëshojë territorin e Republikës së Maqedonisë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se 15 ditë, ose ta rregullojë qëndrimin e tij në pajtim me Ligjin për të huajt.

(2) Nëse personi nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, me të do të veprohet në pajtim me rregullat për të huajt.

Riatdhesimi vullnetar

Neni 80

Me kërkesë të personit të cilit i është njohur mbrojtja ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë, si dhe pas pushimit të të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Komisariati i Lartë për Refugjatë, do të mundësojnë riatdhesim të organizuar vullnetar të personave në vendin e tyre të prejardhjes.

KAPITULLI VII**ZBATIMI I DISPOZITAVE PËR DEPORTIM****Zbatimi i dispozitave për deportim të Ligjit për të huajt**

Neni 81

Në rast kur personi i refuzuar, si dhe personi e drejta për azil e të cilit ka pushuar, është hequr ose anuluar në pajtim me këtë ligj nuk e lëshon territorin e Republikës së Maqedonisë, në kohën e paraparë nga Sektori për Azil, deportimi i tij nga Republika e Maqedonisë, do të zbatohet në pajtim me ligjin dhe rregullat për të huajt.

KAPITULLI VIII**E DREJTA E MBROJTJES SË PËRKOHSHME****Kushti për marrjen e mbrojtjes së përkohshme**

Neni 82

(1) Në rast të ardhjes masive të personave të cilët drejtpërdrejtë vijnë nga shtetet në të cilat jetët e tyre, siguria ose liria u janë rrezikuar me luftë, luftë civile,

okupim, konflikt të brendshëm të shoqëruar me dhunë ose shkelje masive të të drejtave të njeriut, Qeveria mund tu japë mbrojtje të përkohshme.

(2) Qeveria, para skadimit të periudhës së mbrojtjes së përkohshme, e rishqyrton ekzistimin e rrethanave nga paragrafi (1) i këtij neni dhe vendos për vazhdimin ose ndërprerjen e mbrojtjes së përkohshme.

(3) Mbrojtja e përkohshme në Republikën e Maqedonisë zgjat një vit. Kohëzgjatja e përgjithshme e mbrojtjes së përkohshme nuk është më e gjatë se tre vjet.

Neni 83

Të huajit do t'i përfundohet mbrojtja e përkohshme nëse janë plotësuar shkaqet për përjashtimin nga nenet 8 dhe 10 të këtij ligji.

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji

Neni 84

Dispozitat nga nenet 14 (principi i moskthimit), 16 (bashkimi familjar), 27 (hyrja dhe qëndrimi i paligjshëm në Republikën e Maqedonisë), 34 (persona të mitur pa shoqërim), 35 (persona të cenueshëm) dhe 60 (detyrime të përgjithshme) të këtij ligji kanë të bëjnë dhe për personat me mbrojtje të përkohshme.

Informata për të drejtat dhe detyrimet

Neni 85

Sektori për Azil me shkrim, në afatin më të shkurtër të mundshëm, e njofton personin me mbrojtje të përkohshme për të drejtat e tij dhe detyrimet, në gjuhën që mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se personi nën mbrojtje të përkohshme e kupton dhe mund të komunikojë.

Të drejtat e personave nën mbrojtje të përkohshme

Neni 86

(1) Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të:

- qëndrimit dhe kujdesit në Republikën e Maqedonisë gjatë mbrojtjes së përkohshme, në pajtim me mundësit ekonomike të Republikës së Maqedonisë,

- të drejtën e punës, mbrojtje shëndetësore dhe sigurimin invalidor dhe pensional nën kushte të njëjta që janë rregulla adekuate që janë paraparë për të huajt me leje të qëndrimit të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë,

- ndihmës humanitare dhe shërbimeve bazë shëndetësore për personat të papunësuar nën mbrojtje të përkohshme dhe

- arsimit fillor dhe të mesëm, ndërsa në lidhje me shkallët më të larta të arsimit, personat nën mbrojtje të përkohshme janë të barabartë me të huajt me leje qëndrimi të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë.

(2) Qëndrimi nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni nuk do të konsiderohet si qëndrim ligjor në kuptim të Ligjit për të huajt dhe Ligjit për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë.

(3) Për realizimin e të drejtave nga paragrafi (1) i këtij neni kujdeset Ministria për Punë dhe Politik Sociale.

(4) Pas përfundimit të mbrojtjes së përkohshme të personit zbatohen rregullat për të huajt.

Dokumenti i identifikimit për person nën mbrojtje të përkohshme

Neni 87

(1) Ministria e Punëve të Brendshme do t'i evidentojë personat nën mbrojtje të përkohshme dhe do t'u lëshojë dokument identifikimi.

(2) Dokumenti i identifikimit nga paragrafi (1) i këtij neni është i vlefshëm deri në përfundimin e mbrojtjes së përkohshme në Republikën e Maqedonisë.

(3) Dispozitat e nenit 53 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji, kanë të bëjnë edhe me dokumentet e identifikimit për personat nën mbrojtjen e përkohshme.

Parashtrimi i kërkesës për njohjen e të drejtës për azil

Neni 88

(1) Personi nën mbrojtje të përkohshme ka të drejtë në çdo kohë të parashtojë kërkesë për njohjen e të drejtës për azil.

(2) Personi nën mbrojtje të përkohshme, kërkesa e të cilit për njohjen e së drejtës për azil është refuzuar, do ta gëzojë mbrojtjen e përkohshme deri në mbarimin e kohës për të cilën është dhënë.

(3) Për personin nën mbrojtje të përkohshme që ka parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës për azil, për të cilën nuk është marrë vendim gjatë periudhës së mbrojtjes së përkohshme, procedura për njohjen e të drejtës për azil vazhdon edhe pas skadimit të asaj periudhe.

Riatdhesimi vullnetar dhe largimi i detyrueshëm

Neni 89

(1) Pas mbarimit të mbrojtjes së përkohshme në Republikën e Maqedonisë me kërkesë të personit nën mbrojtje të përkohshme, Ministria e Punëve të Brendshme do t'i ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme në pajtim me ligjin për organizimin vullnetar të personave në vendin e tyre të prejardhjes, duke mbajtur llogari për dinjitetin njerëzor.

(2) Në rast kur personi nuk do ta lëshojë territorin e Republikës së Maqedonisë vullnetarisht, largohet detyrimisht nga territori i Republikës së Maqedonisë, në pajtim me rregullat për të huajt.

KAPITULLI IX

PËRPUNIMI DHE MBROJTA E TË DHËNAVE PERSONALE

Baza e integruar për të huaj, duke përfshirë të dhëna për azil, migracione dhe viza

Neni 90

(1) Sektori për Azil përpunon dhe shfrytëzon të dhëna nga baza e integruar për të huaj e cila është e vendosur në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke përfshirë të dhëna

për azil, migracione dhe viza në pajtim me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale dhe rregullat për të huaj, si dhe përpunon edhe të dhëna tjera personale për kërkues të të drejtës për azil, person me status të refugjatit, person nën mbrojtje suspsiduare dhe të dhëna për vendqëndrimin e tyre dhe të drejta që i shfrytëzojnë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Të dhëna personale të cilat përpunohen nga ana e Sektorit për Azil për kërkues të të drejtës për azil, personi me status të refugjatit dhe person nën mbrojtje subsidiare janë: emri personal, mbiemri i vajzërisë, pseudonimi; emri i prindërve; gjinia; dita; muaji dhe viti i lindjes; vendi i lindjes; shtetësia; numri amë; shenjat e gishtërinjve dhe fotografia.

(3) Të dhëna personale të cilët përpunohen nga ana e Sektorit për Azil për anëtarë të familjes së ngushtë të cilët e përkrahin kërkuesin i të drejtës së azilit, personi me status të refugjatit, përkatësisht personi nën mbrojtje subsidiare janë: emri personal; dita, muaji dhe viti e lindjes; vendi i lindjes; shtetësia dhe farefisi.

(4) Të dhënat personale të cilat i përpunon dhe shfrytëzon Sektori i Azilit mbahen për dhjetë vjet nga dita e fillimit të përpunimit të tyre.

Shfrytëzimi i të dhënave nga organet tjera

Neni 91

Sektori për Azil mund të përdorë të dhëna nga organe të tjera që në përputhje me kompetencat e tyre ligjore mbajnë shënime për azilkërkuesit dhe personat me status refugjati dhe personin me status të mbrojtjes plotësuese dhe për qëllimet e përcaktuara me këtë ligj

Shkëmbimi i të dhënave

Neni 92

(1) Të dhënat nga baza e të dhënave për të huajt e integruar, duke përfshirë të dhënat për azilin, migracionin dhe vizat nuk mund të shkëmbehen me vendin e origjinës së personit të cilit i përkasin të dhënat ose me vendin e origjinës së anëtarëve të familjes së tij / saj.

(2) Me qëllim të ekzekutimit të vendimit për përjashtimin nga territori i Republikës së Maqedonisë personit, kërkesa për njohjen e së drejtës për azil e të cilit është refuzuar ose për të cilën ka pushuar e drejta e azilit në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me nenin 50 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme me autoritetet kompetente të vendeve të tjera mund të shkëmbejnë të dhënat e mëposhtme:

- emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendlindjen, gjininë, kombësinë, vendbanimin e fundit dhe adresën e banesës, të dhënat për numrin e anëtarëve të familjes dhe dokumentet e lëshuara nga vendi i origjinës dhe
- shenjat e gishtërinjve dhe fotografinë.

KAPITULLI X

DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 93

Gjobë në shumë prej 20 deri 40 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, i cili:

- dokumentet nga neni 53 paragrafi (1) të këtij ligji i jep në shërbim, përkatësisht shërbehet me dokument të huaj identifikimi sikur me të vetin (neni 53 paragrafi (5)),

- me mbushjen e 18 vjetëve nuk paraqet kërkesë për lëshimin e letërnjoftimit (neni 55 paragrafi (1)) dhe

- nuk e ka kthyer dokumentin e udhëtimit të lëshuar dhe letërnjoftimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme pas pushimit të të drejtës për azil (neni 58).

Neni 94

Gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, i cili:

- nuk i mban si sekrete të dhënat që ka mësuar gjatë procedurës (neni 31 paragrafi (3) dhe neni 32 paragrafi (4)),

- nuk e mban me vete dokumentin e identifikimit ose refuzon ta tregojë atë me kërkesë të personit zyrtar i cili është ligjërish i autorizuar për të legjitimuar (neni 53 paragrafi (4)),

- nuk njofton zhdukjen ose dëmtimin e dokumentit të lëshuar në përputhje me këtë ligj në Ministrinë e Punëve të Brendshme në afat prej dy ditëve (neni 59 paragrafi (1)) dhe

- vepron në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji.

Neni 95

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

KAPITULLI XI

AUTORIZIMI PËR MIRATIMIN E RREGULLËS NËNLIGJORE

Neni 96

Ministri i Punëve të Brendshme miraton rregullë nënligjore për formularin e konfirmimit për qëllimin e shprehur për paraqitje të kërkesës për njohjen e të drejtës për azil, formularin për kërkesën e njohjes së të drejtës për azil, formularin për bisedë fillestare për regjistrimin e azilkërkuarit, formularin e procesverbalit për bisedën e kryer në lidhje me kërkesën e parashtruar për njohjen e të drejtës për azil, formularin e procesverbalit për praninë të kërkesës me shkrim për praninë e të drejtës për azil, formularin e kërkesës për praninë e të drejtës për azil në bazë të bashkimit familjar, mënyrën e marrjes së shenjave të gishtave dhe fotografimin e kërkuarve të së drejtës për azil, formularin dhe mënyrën e lëshimit dhe zëvendësimit të dokumenteve të kërkuarve të të drejtës për azil dhe personave të cilëve u është pranuar e drejta për azil dhe mbrojtje të përkohshme (dokument identifikimi për kërkuar për njohjen e të drejtës për azil, letërnjoftimin e personit me statusin e refugjatit, letërnjoftimin e personit nën mbrojtje subsidiare, dokumentin e udhëtimit të personit me statusin e refugjatit, dokumentin e identifikimit për personat nën mbrojtje të përkohshme) në Republikën e Maqedonisë dhe për mënyrën e mbajtjes së evidencës.

KAPITULLI XII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 97

Rregullat nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 98

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të mbarojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/2003, 66/2007, 142/2008, 146/2009, 166/12, 101/15, 152/15, 55/16 dhe 71/16).

Neni 99

Dokumentet e lëshuara në pajtim me rregullat që kanë qenë të vlefshme deri në hyrjen në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së përcaktuar në ligj.

Neni 100

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/2003, 66/2007, 142/2008, 146/2009, 166/12, 101/15, 152/15, 55/16 dhe 71/16).

Neni 101

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

1142.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРЕСТАНУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕТО НА ЗАКОНОТ ЗА ПОДДРШКА НА ДОМАШНАТА МУЗИЧКА ПРОДУКЦИЈА

Се прогласува Законот за престанување на важење то на Законот за поддршка на домашната музичка продукција,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 4 април 2018 година.

Бр. 08-2437/1
4 април 2018 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
м-р **Талат Цафери**, с.р.